


TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE

Janar 2026


Tiranë, më 17 Shkurt 2026: Në Janar 2026 eksportet e mallrave arritën vlerën 26,7 mld lekë, duke u ulur me 4,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 0,3 %, në krahasim me Dhjetor 2025. Importet e mallrave arritën vlerën 57,9 mld lekë, duke u ulur me 4,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 27,5 %, në krahasim me Dhjetor 2025. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 31,1 mld lekë, duke u ulur me 3,6 %, krahasuar me Janar 2025 dhe me 41,3 %, në krahasim me Dhjetor 2025.

FIG. 1 TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS MUAJVE, NË MILIARD LKË




Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve

Gjatë muajit Janar 2026, në uljen e eksporteve prej 4,5 %, negativisht kanë ndikuar grupet: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me -2,9 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me -1,8 pikë përqindje, "Produkte kimike dhe plastike" me -0,4 pikë përqindje, etj. Pozitivisht kanë ndikuar grupet: "Makinë, pajisje dhe pjesë këmbimi" me +1,4 pikë përqindje dhe "Lëkurë dhe artikujt prej tyre" me +0,1 pikë përqindje.

FIG.2 KONTRIBUTI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR TË EKSPORTEVE, JANAR 2026

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve

Gjatë muajit Janar 2026, në uljen e importeve prej 4,0 %, krahasuar me një vit më parë, kanë ndikuar negativisht grupet: "Materiale ndërtimi dhe metale" me -2,1 pikë përqindje, "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" me -2,0 pikë përqindje, "Produkte kimike dhe plastike" me -1,5 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht ka ndikuar grupi: "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me +2,1 pikë përqindje.

FIG.3 KONTRIBUTI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR TË IMPORTVEVE, JANAR 2026

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere

Në muajin Janar 2026, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Janar 2025 janë: Italia (3,6 %), Kosova (2,0%), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Gjermania (30,2 %), Greqia (31,8 %), etj.

Në muajin Janar 2026, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Italia (10,3 %), Greqia (3,3 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kina (1,8 %), Turqia (13,5 %), etj.

Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 55,4 %, të gjithë tregtisë. Në Janar 2026, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 46,8 % të importeve gjithsej.

TAB. 1 QARKULLIMI I MALLRAVE, JANAR 2026

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		367	35,0		29,6	-423	46,0
2022		481	30,9	950	21,2	-464	51,2
2023		430	-10,4		-8,2	-432	50,5
2024		369	-14,3	894	2,5	-526	41,2
2025		346	-6,1	887	-0,8	-541	39,0
2025	01 - 25	28	-4,5	60	0,1	-32	46,4
	02 - 25	30	-5,3	68	-8,6	-37	44,6
	03 - 25	31	-4,9	74	-1,4	-42	42,5
	04 - 25	30	-13,3	76	0,5	-46	39,5
	05 - 25	32	-7,9	78	-2,1	-46	41,0
	06 - 25	31	-9,0	77	-0,2	-45	40,8
	07 - 25	30	-6,9	83	-2,4	-53	36,5
	08 - 25	20	-8,4	67	-2,7	-47	30,1
	09 - 25	27	-10,7	75	5,6	-48	36,3
	10 - 25	31	1,0	80	3,6	-49	39,1
	11 - 25	28	-6,9	71	-3,0	-43	39,5
	12 - 25	27	5,6	80	1,3	-53	33,6
	Jan-Dhj	346	-6,1	887	-0,8	-541	39,0
2026	01 - 26	27	-4,5	58	-4,0	-31	46,2

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Tregtia e Jashtme](https://www.instat.gov.al/)

Metodologjia

Njoftim i rëndësishëm për përdoruesit

Publikimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme, është subjekt i rishikimeve metodologjike, të cilat mbështeten në të dhënat administrative nga autoritetet doganore.

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicione

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv. Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor. Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Ruman, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri